



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 64/2021 regjistër (JR)
Datë 02.11.2021

Nr. 11 i vendimit
Datë 18.03.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 18.03.2024, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 64/2021, datë 02.11.2021, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 446, datë 16.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet A, Ç, D dhe F të Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, të paraqitura në ankim, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 446, datë 16.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe, për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni ka administruar raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar, hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin konstatohet se:
 - *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
 - *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*
 - *ka kryer deklarim të rremë;*
 - *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportin e vlerësimit të hartuar nga organi ndihmës si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 446, datë 16.09.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Ky vendim është marrë bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

¹ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.04.2018, ka përcjellë në Komision raportin e titulluar “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Adelina Zarka, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”.

i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe në përputhje me ligjin, ka mungesë burimesh financiare për të justifikuar pasuritë e deklaruara prej saj, si dhe gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

ii. Subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe, si pasojë, ndaj saj duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, duke vlerësuar se gjendet në kushtet e shkronjave “a”, “b” dhe “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 446, datë 16.09.2021, të Komisionit, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, duke parashtruar shkaqe që lidhen me shkeljen e parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe kriterin e vlerësimit të pasurisë, në drejtim të zbatimit të ligjit material.
6. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), që të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.
 - Vazhdimin e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, të cilat lidhen me vlerësimin e figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
 - Ndryshimin e vendimit nr. 446, datë 16.09.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë (*ratione materiae*) ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga

data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”) për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 340, datë 16.02.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi.
10. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, ashtu siç analizohet në vijim në këtë vendim, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
11. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit, nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje, mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion edhe për faktin se subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit, nuk ka paraqitur akte, për të cilat të kërkonte marrjen e tyre në cilësinë e provave të reja. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me parimet e procesit të rregullt ligjor

12. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në seancën dëgjimore të datës 16.09.2021, Komisioni ka shpallur njëkohësisht jo vetëm vendimin përfundimtar, por edhe vendimin e ndërmjetëm, marrë me shumicë votash, për sa i përket riçeljes së hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 78 të Kodit të Procedurave Administrative.
13. Në analizë të këtij shkaku ankimor, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, gjatë procesit të hetimit administrativ, i ka dhënë kohën e nevojshme subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave në të cilat ato mbështeten, në çdo rast kur për rrethana faktike apo për arsye objektive,

ajo ka qenë në pamundësi për të zbatuar afatin e përcaktuar paraprakisht prej tij. Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrë prove për konstatimet në rezultatet e hetimit administrativ, duke i përcaktuar dhe afatin për dërgimin e shpjegimeve lidhur me to. Me konsideratë pamundësinë fizike të subjektit të rivlerësimit për shkak të gjendjes shëndetësore, Komisioni ka shtyrë afatin e caktuar për dërgimin e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, si dhe zhvillimin e seancës dëgjimore. Më konkretisht, deri në dhënien e vendimit përfundimtar, Komisioni është shprehur me vendimet e ndërmjetme, si më poshtë.

i. Me vendimin nr. 2, datë 31.05.2021, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për rezultatet e hetimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në lidhje me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe për afatin brenda të cilit do të ushtrohet kjo e drejtë, data 13.06.2021.

ii. Me vendimin nr. 3, datë 08.06.2021, Komisioni ka vendosur të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shtyrje të afatit të dorëzimit të shpjegimeve deri në datën 27.06.2021.

iii. Me vendimin nr. 4, datë 28.06.2021, Komisioni ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit administrativ edhe për dy komponentët e tjerë të rivlerësimit deri në këtë fazë të hetimit, duke rezervuar të drejtën e dëgjimit në seancën dëgjimore lidhur me barrën e provës mbi rezultatet e hetimit dhe më tej, të vlerësimit nëse duhet rihapur hetimi edhe për dy komponentët e tjerë; si dhe e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore publike më datë 26.07.2021.

iv. Me vendimin nr. 5, datë 22.07.2021, Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 26.07.2021, për mosparaqitjen e subjektit për arsye shëndetësore, duke i sjellë në vëmendje se procesi kalimtar është i kufizuar në kohë dhe në rast pamundësie për të qenë prezent, subjekti i rivlerësimit mund të përfaqësohej nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor. Komisioni ka caktuar zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 07.09.2021.

v. Me vendimin nr. 6, datë 03.09.2021, Komisioni, duke parashtruar se ka shtyrë disa herë seancat dëgjimore të planifikuara dhe duke i rikujtuar subjektit të rivlerësimit faktin e procesit të kufizuar në kohë dhe mundësinë e përfaqësimit në këtë proces nga një përfaqësues ligjor, nuk e ka pranuar kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore, duke vendosur me vijimin e saj sipas planifikimit, më datë 07.09.2021.

vi. Me vendimin nr. 7, datë 07.09.2021, për arsye se në seancën dëgjimore të planifikuar për këtë datë, subjekti i rivlerësimit dhe as përfaqësuesi i tij ligjor nuk ishin prezentë, Komisioni, pasi ka informuar lidhur me ecurinë e procesit dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancave dëgjimore, mbështetur në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, ka vendosur të shtyjë vijimin e seancës dëgjimore për në datën 14.09.2021, për të mundësuar dëgjimin e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit administrativ.

vii. Me vendimin nr. 8, datë 14.09.2021, Komisioni ka vendosur që shqyrtimi i kërkesës së paraqitur në mënyrë të përsëritur nga subjekti i rivlerësimit, për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy komponentët e tjerë të rivlerësimit, të bëhej pasi të administroheshin shpjegimet dhe dokumentacioni përkatës që ajo do të depozitonte gjatë seancës dëgjimore. Komisioni i ka bërë me dije subjektit se do të njoftohet për vendimin lidhur me këtë kërkesë në seancën vijuese.

viii. Me vendimin nr. 9, datë 15.09.2021, Komisioni, pasi ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën mbi rezultatet e hetimit lidhur me kriterin e pasurisë, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit administrativ për dy komponentët të tjerë të rivlerësimit dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit për këtë vendim, në seancën vijuese.

14. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, edhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni, me të drejtë, më datë 15.09.2021, ka marrë vendimin për mospranimin e kërkesës së përsëritur të subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 14.09.2021, kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jepte qëndrimin përfundimtar në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj dhe, pasi subjekti ka ripërsëritur kërkesën për riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, është shprehur: “[...] e morëm kërkesën tuaj të dhënë në këtë seancë dhe do t’ju njoftojmë në vijim, pasi të shqyrtojmë shpjegimet e dhëna nga ju gjatë seancës, si dhe provat e depozituara në përgjigje të barrës së provës edhe sot në seancën dëgjimore. Atëherë, trupi gjykues tërhiqet për vendim dhe seanca do të rifillojë në datën 16 shtator [...]”. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, tashmë ishte e qartë se hapja ose e jo e hetimit për vlerësimin e dy kriterëve të tjera do të varej nga vlerësimi përfundimtar që Komisioni do të bënte lidhur me provat e sjella prej saj për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe nga fakti nëse provat do të mund të përmbysnin konkluzionet paraprake të Komisionit, lidhur me këtë kriter. Një gjë e tillë mund të ndodhte vetëm gjatë bisedimeve për marrjen e vendimit, sipas nenit 55, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

15. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se shpallja e vendimit të ndërmjetëm për refuzimin e riçeljes së hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, në të njëjtën seancë me shpalljen e vendimit përfundimtar, nuk i ka cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

i. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni është treguar dyshues për raportet për paaftësi për punë të përcjella nga Spitali Rajonal Fier për gjendjen shëndetësore, i cili në mungesë të saj ka zhvilluar seancën dëgjimore, duke mos respektuar afatin 15-ditor për njoftimin, në kundërshtim me parimet të Kushtetutës, nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe me pikat 10 dhe 11 të rregullores së Komisionit “Hapat proceduralë të unifikuar”, nga verifikimi i komunikimeve nëpërmjet postës elektronike me*

subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues, në vijim të konstatimeve të pasqyruara në paragrafin 13 të këtij vendimi, vëren se Komisioni ka pranuar kërkesat e paraqitura prej saj më 19.07.2021 dhe më 01.09.2021, për shtyrje të seancës dëgjimore për pamundësi të saj për të qenë prezente në seancë për arsye shëndetësore. Komisioni, në vendimin² për shtyrjen e seancës dëgjimore, i ka sjellë në vëmendje subjektit të rivlerësimit se, duke qenë se procesi i rivlerësimit kalimtar është i kufizuar në kohë, në rast se ajo përsëri do ta kishte të pamundur paraqitjen në seancën e datës 07.09.2021, mund të përfaqësohej në të nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor. Në këtë datë, Komisioni ka zhvilluar seancën dëgjimore duke relatuar gjetjet e hetimit administrativ të njohura nga subjekti rreth tre muaj më parë, për t'i dhënë mundësinë asaj për të marrë pjesë në seancë me qëllim paraqitjen e shpjegimeve dhe depozitimin e provave të tjera. Për këtë qëllim, Komisioni ka shtyrë seancën dëgjimore në datën 14.09.2021, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në mënyrë aktive. Në seancën e datës 16.09.2021, në praninë e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka shpallur vendimin për shkarkimin e saj nga detyra.

Komisioni i ka kërkuar informacion në rrugë zyrtare, por edhe përmes komunikimeve elektronike, Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, për t'u informuar lidhur me prezencën në punë të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës maj-qershor-korrik 2021. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier³ ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në punë nga data 07.06.2021 deri më 17.09.2021, për shkak të pajisjes me raport mjekësor.

16. Lidhur me këtë shkak ankimi, sikurse konstatohet nga analiza e fakteve të pasqyruara më lart, konkretisht dhënia e kohës së mjaftueshme në dispozicion për paraqitjen e shpjegimeve, shtyrja e herëpashershme e zhvillimit të seancës dëgjimore, dëshmojnë qartë se Komisioni ka respektuar gjendjen shëndetësore të subjektit të rivlerësimit dhe pasojën që ka dhënë ajo në zhvillimin e procesit, edhe pse i kishte sjellë në vëmendje, në mënyrë konstante, mundësinë për t'u përfaqësuar nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor. Kërkesa e Komisionit për të verifikuar prezencën në punë të subjektit të rivlerësimit, gjatë kohës së gjendjes së raportit mjekësor, vlerësohet nga trupi gjykues, si një veprim i duhur, në kushtet e nevojës për të verifikuar sjelljen e subjektit në raport me procesin e rivlerësimit, me fokus parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016⁴.
17. Trupi gjykues nuk e gjeti të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, edhe në referim të pikës 11 të rregullores së Komisionit “Hapat procedurale të unifikuar”, sipas së cilës afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t'u dëgjuar në seancë, ndërkohë afatet procedurale administrative për njoftimin e subjektit të rivlerësimit janë tejkaluar dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke i dhënë mundësinë për të qenë e pranishme në seancë. Për rrjedhojë, rezulton se Komisioni nuk ka vepruar në shkelje të ndonjë përcaktimi ligjor, në drejtim të afateve të njoftimit për zhvillimin e seancës dëgjimore, përkundrazi

² Me vendimin e datës 23.07.2021.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.09.2021.

⁴ Neni 48 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit”.

me vendimet për shtyrjen e seancave dëgjimore, i ka garantuar asaj të drejtat në zbatim të parimit të procesit të rregullt ligjor.

18. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 pasi nuk ka vlerësuar në mënyrë kumulative, por në mënyrë alternative dy kriteret e pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.*
19. Sa i përket këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji, në jurisprudencën e konsoliduar të tij, sa i takon interpretimit dhe zbatimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur qëndrimin se kriteri i vlerësimit të pasurisë dhe ai i kontrollit të figurës janë dy kritere të pavarura dhe, si të tilla, edhe pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për këto dy kritere, duhet të konsiderohen në mënyrë të pavarur. Deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës sipas parashikimeve të nenit 39 dhe deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33, parashikohen si raste të veçuara në kuadër të pamjaftueshmërisë në deklarim. Vlerësimi për secilin prej tyre bazohet në dispozita të ndryshme, të cilat trajtojnë dy kritere të ndryshme të kontrollit në procesin e rivlerësimit. Në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vendimi për procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, që do të thotë se ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit vetëm për një kriter dhe të marrë një vendim për shkarkimin nga detyra të subjektit, bazuar vetëm në këtë kriter vlerësimi. Në këtë kuptim, nuk kërkohet që deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të pasurisë, të ekzistojnë detyrimisht njëkohësisht që të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por mjafton vetëm njëri prej tyre për të arritur në këtë përfundim. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ky shkak ankimor nuk është i bazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit.
20. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe paracaktuar, pasi hetimi administrativ ka përfunduar, bazuar vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pa u hetuar për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale.*
21. Trupi gjykues, në vijim të qëndrimit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, vlerësoi se parashikimi i nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përcakton qartë se procesi i rivlerësimit jo domosdoshmërisht fillon dhe përfundon me shqyrtimin e tri kriterëve të procesit të rivlerësimit. Ky interpretim shihet në lidhje të ngushtë e në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 1 parashikon se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Ky parashikim i interpretuar *a contrario* lejon përfundimin e procesit të rivlerësimit edhe mbështetur vetëm në një ose dy kritere, për ato raste kur, për Komisionin, rezulton se nga hetimet e kryera për këto kritere, subjekti nuk

arrin një nivel të besueshëm, aq sa konfirmimi në detyrë nuk është më një opsion i vlefshëm. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

22. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se: *Komisioni në mënyrë kontradiktore ka vlerësuar si të mjaftueshëm vlerësimin vetëm të kontrollit të pasurisë duke vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi gjendet në kushtet e shkronjave “a”, “b” dhe “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që neni 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, parashikon shprehimisht: “deklarim i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikt interesi”* – trupi gjykues, pasi kontrolloi vendimin e Komisionit, nga përmbajtja e tij, vëren se Komisioni nuk ka konsideruar bindëse vlerën e investimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë, me sipërfaqe totale 1.035 m²” në Fier dhe, për këtë arsye, ka vlerësuar se duhet të marrë në konsideratë vlerën e investimit sipas kostove të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 2001, e llogaritur ajo për 50% të vlerës së pasurisë dhe referuar kësaj vlere, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar investimin, në shumën prej (-)5.789.173 lekësh. Sa më sipër, trupi gjykues e konsideron “lapsus” shprehjen e përdorur nga Komisioni në vendim, se subjekti i rivlerësimit *gjendet në kushtet e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016*, në një kohë që duhet të konkludonte, referuar përmbajtjes së vendimit, se subjekti i rivlerësimit *gjendej në kundërshtim me parashikimet e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016*.
23. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni nuk ka respektuar parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit, duke vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016*.
24. Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se analiza lidhur me respektimin ose jo të parimit të proporcionalitetit në dhënien e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është objekt kontrolli nga ana e Kolegjit në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit, të cilat kanë çuar në marrjen e vendimit për shkarkimin e subjektit. Referuar nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji gjatë shqyrtimit të çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, të cilët orientojnë në vlerësimin që masa disiplinore e aplikuar ndaj subjektit të rivlerësimit të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer. Nga verifikimi i procesit të rivlerësimit të kryer në Komision dhe nga kontrolli i vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni e ka bazuar vendimmarrjen e tij në vlerësimin e provave të administruara kryesisht gjatë hetimit administrativ, në shpjegimet dhe prapësimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe provat e depozituara prej saj, duke i çmuar ato me objektivitet dhe në proporcion me atë çfarë ka rezultuar në përfundim të vlerësimit të tyre. Bazuar në sa më sipër, si dhe në konkluzionet e arritura në vijim në këtë vendim, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.
25. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së subjekteve para ligjit, parimin e sigurisë juridike duke e vendosur në një pozitë diskriminuese, pasi në raste të*

ngjashme rivlerësimi, ka mbajtur standarde të ndryshme, referuar praktikës së konsoliduar të Komisionit dhe të Kolegjit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

26. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk i ka ngritur këto pretendime gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, madje as gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore publike. Gjithashtu, nga kontrolli i procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision, trupi gjykues nuk konstatoi sjellje të Komisionit në shkelje të parimeve kushtetuese dhe të parimeve të një procesi të rregullt ligjor, apo që subjekti i rivlerësimit të jetë vendosur në një situatë të disfavorshme apo diskriminuese. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjnë *a priori* shkak për të konsideruar si të padrejtë apo të pavlefshëm vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjerë të rivlerësimit nga Komisioni, qëndrim ky i konsoliduar tashmë në vendimmarrjet e Kolegjit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt shqyrtimi do t'i nënshtrohet kontrollit nga Kolegji, në përputhje me jurisprudencën e tij dhe ligjin e zbatueshëm. Në konsideratë të jurisprudencës së deritanishme, trupi gjykues vlerëson se edhe në rastet që në pamje të parë duken të krahasueshme ose të ngjashme, në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura në to, Kolegji nuk mund të krahasojë vendimet e ndryshme të dhëna nga Komisioni për subjekte të ndryshme rivlerësimi. Në konkluzion, ky shkak ankimi u vlerësua nga trupi gjykues si i pabazuar në ligj e në prova.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

27. Trupi gjykues mori në shqyrtim dhe analizoi shkaqet e ankimit lidhur me pasurinë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë, me sipërfaqe totale 1.035 m²”, në Fier, mbi të cilat subjekti i rivlerësimit ka mbështetur kundërshtimin e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, si vijon.
28. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzionet e Komisionit, në vendim, janë të gabuara, pasi: (i) qëndrimi i Komisionit lidhur me koston e ndërtimit të kësaj pasurie, nuk përputhet me dokumentacionin e dorëzuar prej saj lidhur me investimin e kryer realisht nga ajo dhe personi i lidhur; (ii) deklarimi i shitjes së apartamentit me sipërfaqe 66,04 m² në çmimin 4.500.000 lekë dhe jo 600.000 lekë sa është shënuar në kontratën e shitjes, duhej të konsiderohej nga Komisioni “gjë e gjykuar” dhe të konsiderohej si e ardhur e ligjshme; (iii) huatë që kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet për ndërtimin e pasurisë, janë deklaruar nga bashkëshorti i saj në vitin 2003, në plotësimin e formularit për marrjen e certifikatës së sigurisë dhe duhet të konsideroheshin nga Komisioni si burime financiare të përdorura nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.
29. Në përfundim të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli, në vendim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *1.25 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i*

rivlerësimit, arrin në përfundimin se masa administrative e dhënë nga ILDKPKI-ja për deklarim të rremë, si dhe pagimi në vitin 2018 i vlerës përkatëse të gjobës, nuk përmbush kërkesat e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk legjitimon vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si një e ardhur e ligjshme për krijimin e pasurisë së deklaruar. Gjithashtu, për trupin gjykues, mbetet e paprovuar vlera reale e shitjes së kësaj pasurie, e cila rezulton edhe më e lartë se vlera e tregut, po ashtu nuk u gjet as ndonjë lidhje mes shumës së derdhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në bankë në datën 17.5.2000. 1.26 Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të pranuar si burim edhe huatë e deklaruara prej saj gjatë pyetësorëve të Komisionit, trupi gjykues ka vlerësuar se ato nuk janë deklaruar as më parë dhe as në deklaratën “vetting” dhe se subjekti ka deklaruar si burim për ndërtimin e kësaj pasurie një burim tjetër dhe deklaratat e paraqitura si provë nuk mund të pranohen si të besueshme (në kuptimin e vlerës së tyre provuese). Ky vendim vjen edhe në vijim të një praktike të konsoliduar të vendimeve të ngjashme nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. 1.27 Në vlerësim të trupit gjykues, kostoja e llogaritur, duke iu referuar çmimeve të vitit 2001, është mesatare dhe oportune referuar edhe shtrirjes së investimit (momentit të fillimit të punimeve dhe përfundimit të tyre), e cila është shoqëruar dhe me llogaritje të shpenzimeve nga Komisioni në një shtrirje përgjatë viteve 2000 – 2003. Në përfundim, trupi gjykues ka vlerësuar se duhet të marrë në konsideratë vlerën e investimit sipas kostove të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 2001, e llogaritur ajo për 50% të vlerës së pasurisë, sipas deklarimeve të subjektit, rezulton me një balancë negative në vlerën (-) 5.789.173 lekë. 1.28 Kjo situatë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit, e cila përputhet edhe me deklaratimet periodike vjetore (deklaruar rregullisht edhe si adresë banimi, edhe përfitimin e të ardhurave nga qiradhënia e disa ambienteve), e vendos atë në kushtet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

30. Nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se:

30.1 Për pasurinë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë, me sip. totale 1035 m²”, në Fier (në vijim “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”), subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar: Shtëpi banimi me nr. pasurie {***}, ZK {***}, sipërfaqe 105 m², e prishur, ndërtuar shtëpia e re me nr. të ri pasurie {***}, me dy kate banimi dhe një kat magazinë, sipërfaqe kati përdhe 345 m², sipërfaqe kati i parë 354 m², sipërfaqe kati i dytë banimi 336 m² (sip. totale 1.035 m²), me vlerë 10.000.000 lekë, së bashku me vëllanë e bashkëshortit, pjesa takuese 50%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga shitja e apartamentit me nr. pasurie {***}, ndodhur në ZK {***}, me sip. 66,04 m², me kontratën e shitblerjes, datë 17.05.2000, në vlerën 600.000 lekë, realisht shitur 4.450.000 lekë.

30.2 Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament banimi 3+1, me sipërfaqe totale 220 m², e ndodhur në një ndërtesë 3-katëshe në lagjen “{***}”. Pjesa takuese 50%. Vlera: 5.000.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat financiare janë siguruar nga shitja e një apartamenti të privatizuar në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, shitur në shumën 4.500.000 lekë.

30.3 Referuar informacionit të përcjellë në Komision nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Fier⁵, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. J. Z., ka në pronësi me dy bashkëpronarë të tjerë, ndërtesën me sip. 318,3 m², në zonën kadastrale {***}.

30.4 Referuar informacionit të përcjellë nga Bashkia Fier subjektit të rivlerësimit dhe të depozituar nga ky i fundit në Komision, nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Fier është lëshuar në emër të z. L. Z. (vjezhri i subjektit të rivlerësimit) leja e ndërtimit nr. {***}, datë 17.04.2000, për objektin “magazinë + 2 kate banesë”. Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Fier i ka përcjellë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier⁶, dokumentacionin tekniko-ligjor për regjistrimin e objektit “magazinë + 2 kate banesë”, ndërmjet të tjerave edhe akt kontrollin e datës 26.04.2004, të kryer nga përfaqësuesit e Zyrës së Urbanistikës së Bashkisë Fier në objektin me investitor qytetarin L. Z. dhe zbatues shoqërinë “{***}” ShPK; akt kolaudimin e datës 27.04.2004; si dhe lejen e shfrytëzimit të objektit në emër të z. L. Z. të datës 28.04.2004.

30.5 Objekti është regjistruar në emër të z. L. Z. dhe nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier është lëshuar vërtetimi hipotekor me nr. {***}, datë 20.07.2005, në të cilin, në seksionin “Komente nga regjistruesi”, citohet: *Truall shtet, magazina me sipërfaqe ndërtimi 345 m², kati i parë i banesës 354 m², kati i dytë i banesës 336 m², shoqëruar me plan rilevimi, e cila rezulton me sipërfaqe përdhe 318,3 m², kati i parë 354 m², kati i dytë 336 m².*

30.6 Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2017, të të ndjerit, z. L. Z., në datën 04.01.2018 është regjistruar kalimi i pronës “magazinë + 2 kate banesë” në emër të trashëgimtarëve të tij, z. J. Z. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), z. A. Z. (kunati i subjektit të rivlerësimit) dhe znj. N. Z. (vjezhra e subjektit të rivlerësimit), me pjesë takuese 1/3 secili.

30.7 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni dhe në përgjigje të barrës së provës së kaluar me rezultatet e hetimit administrativ, ashtu si edhe në ankim, lidhur me kohën dhe vlerën e investimit në ndërtimin e objektit “magazinë + 2 kate banesë”, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Pjesë takuese në banesë kam deklaruar pjesën prej 220 m², pa kryer ndonjë matje të saktë, por duke u bazuar në përmasa të afërta dhe në faktin se kjo është sipërfaqe banimi që përdoret prej familjes sime aktualisht. Pjesa tjetër ku banon familja ime, është e prindërve, të cilët kanë edhe në katin e dytë në të njëjtin seksion, ndërsa për sa i përket magazinës, ajo nuk është ndarë, është një e tërë sipas marrëveshjes verbale të arritur mes tyre para fillimit të ndërtimit. Pavarësisht se sipas Entit Kombëtar të Banesave, vlera e ndërtimit të kësaj banese duhej të ishte 22.000.000 - 24.000.000 lekë, për ndërtimin e kësaj banese, deri në momentin që kemi hyrë në banesë, familja ime, prindërit e bashkëshortit dhe vëllai i bashkëshortit, kemi investuar deri në vlerën 10.000.000 lekë, kjo është shuma e deklaruar prej meje, pasi kam pyetur prindërit e bashkëshortit, pasi ata kanë mbikëqyrur të gjitha shpenzimet e kryera për*

⁵ Informacioni i përcjellë në Komision nga ASHK Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.2.2020.

⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.06.2004.

investim. Kjo shumë ka rezultuar në gjithë veprimet e pagesave të mbajtura në fletore shënimesh nga prindërit dhe nusja e vëllait të bashkëshortit [...]. Ndërtimi i godinës është zhvilluar gradualisht sipas mundësive financiare, duke filluar punimet në pranverë të vitit 2000 dhe në vitin 2004 është marrë leja e shfrytëzimit, duke hyrë në banesë të papërfunduar. Ky ka qenë shkaku i deklaramit të vlerës prej 10.000.000 lekësh dhe, për të provuar që ndërtimi ka zgjatur ndër vite, ky fakt provohet me foto të bëra në kohën e lyerjes së datës 15.01.2014.

31. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, lidhur me vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, ka bërë krahasimin me vlerën referuese të kostos mesatare për m² për sipërfaqe ndërtimi, sipas Entit Kombëtar të Banesave. Komisioni, në vendim⁷, ka arsyetuar se: *Referuar vendimit nr. 362, datë 14.7.2000, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”, kostoja e ndërtimit për vitin 2001 është në vlerën 22.737 lekë/m². Sipas një llogaritjeje, vlera totale e investimit për këtë pasuri me sipërfaqe totale 1.035 m², është në vlerën 23.532.795 lekë. Nëse kësaj kostoje do t’i zbrisnim vlerën e TVSh-së (20%), si dhe fondin rezervë (5%), në total 25%, vlera shkon 17.649.596 lekë (duke mbajtur në konsideratë shpjegimet e subjektit se për punimet e kryera, nuk janë paguar fatura me TVSh). Kjo vlerë është llogaritur me rezervë, pasi objekti, sipas të dhënave të rezultuara gjatë hetimit, është ndërtuar në vitet 2000 - 2003.*

Në analizën financiare, për të përllogaritur mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie në periudhën 1990-2003, Komisioni ka llogaritur vlerën prej 8.824.798 lekësh, si vlerë të investuar prej tyre, referuar pjesës takuese prej 50% të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit⁸.

32. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, duke kundërshtuar vlerën e përllogaritur si kosto e ndërtimit të këtij objekti nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se konkluzioni i Komisionit, si më sipër cituar, ishte i gabuar pasi ajo ka deklaruar vlerën e investimit dhe jo koston e ndërtimit, të cilat janë dy koncepte të ndryshme. Dokumentacioni i kohës, i depozituar prej saj në Komision, në formën e shënimeve manuale, të mbajtura jo prej saj, por prej nënës dhe nuses së vëllait të bashkëshortit, tregon qartë dhe me objektivitet vlerën reale të shpenzimeve të kryera.

Për të provuar këto pretendime, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision edhe raportin e ekspertimit kontabël nr. {***}, datë 21.06.2021, i audituesit ligjor A. M.⁹, përfundimet e të cilit i ka bërë pjesë të argumenteve të parashtruara në ankim, lidhur me vlerën e investimit në pasurinë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”. Eksperti i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit u është referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 362, datë

⁷ Paragrafi 1.4 i vendimit të Komisionit.

⁸ Tabela nr. 2, faqe 7 e vendimit të Komisionit.

⁹ Raporti i ekspertimit kontabël nr. {***}, datë 21.06.2021, i audituesit ligjor A. M., i përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, është depozituar nga kjo e fundit në Komision, bashkëlidhur prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, më datë 29.06.2021.

14.07.2000, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, për vitin 2000, duke e bazuar analizën e tij në koston mesatare të ndërtimit për m², për këtë vit, në vlerën 21.202 lekë dhe sipërfaqen e pasurisë prej 1.035 m². Nga vlera totale e llogaritur mbi bazën e këtyre dy treguesve janë zbritur disa zëra punimesh dhe në konkluzion, sipas audituesit ligjor, vlera e punimeve rezulton të jetë 10.253.326 lekë dhe 50% e kësaj vlere, si pjesa takuese e investuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në shumën prej 5.126.663 lekësh.

33. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me arsyetimin dhe konkluzionin e arritur nga Komisioni dhe faktet e rrethanat e pasqyruara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit¹⁰ se, në kushtet kur subjektet e rivlerësimit nuk arrijnë të provojnë koston reale të ndërtimit të pasurive në pronësi të tyre, referimi të çmimet e aplikuara prej Entit Kombëtar të Banesave në vitet përkatëse, do të konsiderohet si një standard ligjor i pranuar për llogaritjen e tyre. Komisioni, me të drejtë, nuk i është referuar vlerës së investimit të pretenduar, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqiste dokumentacion që do të provonte bindshëm vlerën prej 5.000.000 lekësh, të pretenduar si investim për ndërtimin e pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”. Shënimet e mbajtura nga familjarët e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në formë manuale, si një listim i thjeshtë shpenzimesh, dhe nuk janë të shoqëruara me dokumentacion provues financiar, si: faturë, mandat pagese, mandat arkëtimi apo situacion punimesh. Trupi gjykues konstatoi se e njëjta mangësi në dokumentacionin provues, shoqëron edhe raportin e ekspertimit kontabël të audituesit ligjor, konkluzionet e të cilit janë përfshirë nga subjekti i rivlerësimit në përmbajtje të ankimit. Për më tepër, argumentet e përdorura nga audituesi ligjor në përlllogaritjet e kryera, të cilat lidhen me zbritjen e vlerave të disa zërave nga kostoja totale e ndërtimit, nuk përputhen me të dhënat e të vetmit dokumentacion provues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, lista e shpenzimeve në formën e shënimeve manuale të mbajtura nga familjarët e bashkëshortit të saj. Audituesi ligjor ka zbritur nga kostoja totale e ndërtimit, masën prej 36,2% të saj, si vlerë kostoje për punëtorë dhe pagesa për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëtorëve, si dhe 10,5% si vlerë e fitimit të situacionuar të nënkontraktorit dhe shpenzime në strukturë, me pretendimin se ndërtimi është kryer nga vetë familjarët e subjektit të rivlerësimit, por nga verifikimi i shënimeve të mbajtura nga familjarët e subjektit të rivlerësimit si listë e shpenzimeve të kryera, trupi gjykues konstatoi se në to janë shënuar pagesa të kryera për punëtorë, të cilët kanë kryer punime në faza të ndryshme të ndërtimit të objektit. Gjithashtu, referuar fotove të pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe të dhënave të akt-kontrollit të datës 26.04.2004, të kryer nga përfaqësuesit e Zyrës së Urbanistikës së Bashkisë Fier, në përfundim të punimeve të ndërtimit të objektit “magazinë + 2 kate banesë”, në të cilin citohet: “investitori L. Z. dhe zbatues shoqëria “{***}” ShPK”, trupi gjykues krijoi bindjen se ndërtimi i objektit nuk mund të jetë kryer vetëm me punën e familjarëve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Një

¹⁰ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019 etj.

pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit konsiderohet i pabazuar në prova dhe ligj, referuar kjo edhe në jurisprudencën e Kolegjit¹¹, sipas së cilës nuk janë konsideruar si të zbritshme shpenzimet për fuqinë punëtore.

33.1 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, të pasqyruar edhe në raportin e audituesit ligjor, se duhet të zbriten nga kostoja totale e ndërtimit edhe shpenzimet e kryera për suvanë e brendshme, suvanë e jashtme dhe lyerjen e brendshme dhe të jashtme të ndërtesës, të cilat janë kryer në vitet 2010-2014, nga fotot e ndërtesës të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi se nuk provohet bindshëm data së cilës ato i përkasin. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se këto foto i përkasin datës 15.01.2014, por nga verifikimi i tyre rezultoi se në disa prej fotove, nuk është shënuar asnjë element përkatës që të provojë datën kur ato janë realizuar, ndërsa në disa të tjera, në fund të tyre, në krahun e djathtë shënohet data e prodhuar nga aparati fotografik 03.04.2020. Në vlerësim të trupit gjykues¹², këto foto nuk arrijnë të provojnë se ndërtesa nuk ka pasur investime/shpenzime të të njëjtit lloj dhe më herët në kohë, për më tepër kur bëhet fjalë për shpenzime për lyerje e suvatime të brendshme apo të jashtme të ndërtesës, duke e bërë të pabesueshëm versionin e subjektit të rivlerësimit, për pasojë pretendimi i saj për zbritjen e këtyre shpenzimeve nga totali i kostos së ndërtimit, mbeti në nivel deklarativ.

33.2 Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit për uljen e kostos së ndërtimit në masën 20% si vlerë e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe 5% si vlerë e fondit rezervë. Në funksion të përlllogaritjes së kësaj vlere, trupi gjykues konstatoi se vlera e përlllogaritur prej Komisionit si kosto e ndërtimit të objektit, ka dalë pasi edhe Komisioni ka aplikuar një zbritje prej 25% mbi vlerën e kostos së përlllogaritur sipas çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave, e cila përbëhej nga vlera e zërit të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe vlerën e fondit rezervë, qëndrim ky që vjen ndesh me qëndrimet e mbajtura prej Kolegjit në jurisprudencën e tij¹³. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, konfirmon më së paku zbritjen në masën 25% të kostos së ndërtimit, ashtu siç është përlllogaritur në vendim nga Komisioni.

- 34.** Trupi gjykues vlerësoi se referimi nga ana e Komisionit në vlerat e kostove të ndërtimit, publikuar nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe në kriteret për ndërtimin e banesave të përcaktuara në vendimin nr. 362, datë 14.07.2001, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, nuk është qëndrimi i drejtë, në përputhje me rrethanat faktike të provuara gjatë hetimit administrativ. Referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se objekti është ndërtuar gjatë viteve 2000 - 2003, të dhënave të lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 17.04.2000, për objektin “magazinë + 2 kate banesë”, si dhe të dhënave të lejes së shfrytëzimit të objektit të

¹¹ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019.

¹² Neni 278 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: “Filmat fotografikë ose filmat kinematografikë, kasetat e çdo lloji, si dhe çdo lloj tjetër regjistrimi, mund të përbëjnë provë për ngjarjet e sendet që janë regjistruar, kur gjykata bindet për saktësinë e vërtetësinë e tyre [...]”.

¹³ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; vendimi i Kolegjit nr. 7/2022 (JR), datë 29.03.2022.

datës 28.04.2004, trupi gjykues arrin në konkluzionin se si kohë e ndërtimit të tri kateve të objektit, duhet të konsiderohet periudha kohore 2000 - 2003. Në funksion të një vlerësimi sa më objektiv të çështjes, trupi gjykues vlerësoi se kostoja e ndërtimit të pasurisë duhet të përlllogaritet bazuar në vlerën mesatare të koston së ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave, për periudhën 2000 - 2003. Në këtë logjikë, kostoja mesatare e ndërtimit për m^2 , për katër vitet e periudhës 2000 - 2003, për qytetin e Fierit, përlllogaritet në vlerën 22.064 lekë/ m^2 , referuar të dhënave që burojnë nga aktet ligjore përkatëse të miratuara për koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave¹⁴. Në përfundim të korrektimit të përlllogaritjes së koston së ndërtimit të pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, mbështetur mbi konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arriti në konkluzionin se kostoja e ndërtimit të kësaj pasurie për m^2 është në vlerën 22.064 lekë/ m^2 dhe vlera totale e koston së ndërtimit për sipërfaqen e ndërtimit 1.035 m^2 është 22.836.240 lekë. Duke zbritur nga kjo vlerë 20% vlerën e TVSh-së dhe 5% vlerën e fondit rezervë, vlera totale e koston së ndërtimit rezulton 17.127.180 lekë. Pjesa e investuar prej subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në pjesë takuese prej 50%, është në vlerën 8.563.590 lekë, nga 8.824.798 lekë e llogaritur nga Komisioni. Diferenca në vlerën e investimit është ndikuar nga kostoja mesatare e ndërtimit, e cila, siç është arsyetuar më sipër, nga Kolegji është llogaritur si mesatare e viteve 2000 - 2003, ndërkohë që nga Komisioni është llogaritur me koston mesatare të vitit 2001. Në një vlerësim të përgjithshëm të sa më sipër trajtuar, referuar dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit¹⁵, në kushtet kur gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me vlerën e investimit të pretenduar për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues vlerësoi se nuk mund të penalizohet subjekti i rivlerësimit për deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e pasurisë, vetëm mbi bazën e një niveli krahasimor të vlerës së deklaruar me atë që rezulton nga përlllogaritja e koston së ndërtimit të saj sipas çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave. Për pasojë, trupi gjykues nuk e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim, se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerën e investimit të deklaruar për ndërtimin e pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, në deklaratën e rivlerësimit.

35. Trupi gjykues analizoi në vijim edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, të parashtruara në ankim, të cilat kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit për mundësinë e saj dhe

¹⁴ Konkretisht, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 14.07.2000, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2000 është në vlerën 21.202 lekë/ m^2 ; referuar udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 31.05.2001, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2001 është në vlerën 22.737 lekë/ m^2 ; referuar udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 16.10.2002, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2002 është në vlerën 23.214 lekë/ m^2 ; referuar udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 8.05.2003, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2003 është në vlerën 21.103 lekë/ m^2 .

¹⁵ Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 35, datë 22.09.2022.

të personit të lidhur për të financuar me burime të ligjshme, ndërtimin e pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”.

36. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se të ardhurat nga shitja e pasurisë “apartament me sipërfaqe 66,04 m² në Fier”, në vitin 2000, të cilat kanë shërbyer si burim për financimin e ndërtimit të pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, nuk duhen konsideruar në vlerën 600.000 lekë, sa i ka llogaritur Komisioni referuar kontratës së shitblerjes së banesës, por 4.450.000 lekë sa ka qenë vlera reale e shitjes së saj.

Subjekti i rivlerësimit, në ankim, duke mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse në deklaratimet e saj gjatë hetimit administrativ në Komision, ka argumentuar se lidhur me çmimin e shitblerjes së apartamentit, fiksuar në kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2000, vlera prej 600.000 lekësh e shënuar në kontratë është një lapsus, pasi pasuria realisht është shitur në shumën 4.450.000 lekë. Vlera reale e shitjes përkon dhe me çmimin e tregut, referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 31.05.2005, “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit “K””, për vitin 2000, për qytetin e Fierit, sipas të cilit vlera e shitjes për këtë banesë rezulton të jetë 3.106.818 lekë. Ky lapsus nuk ka pasur si qëllim shmangien nga pagimi i tatimeve për të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit. Në ditën e lidhjes së kontratës së shitblerjes së apartamentit, më datë 17.05.2000, bashkëshorti i saj, menjëherë, pas marrjes së çmimit të shitjes, ka arkëtuar pjesën më të madhe në Tirana Bank, për t’i tërhequr në vijim, sipas nevojave për ndërtimin e pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pikërisht, për shkak të deklaratimit të pasaktë të çmimit të shitjes së banesës, është ndëshkuar me gjobë nga ILDKPKI-ja. Lidhur me këtë çështje, ajo ka zbatuar vendimin nr. {***}, datë 28.03.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke paguar gjobën e caktuar. Kjo masë gjobe është më e madhe se diferenca e papaguar e tatimit mbi të ardhurat, të cilit, sipas gjetjes së Komisionit, subjekti i rivlerësimit i është shmangur, duke vendosur çmimin e shitjes së banesës në shumën 600.000 lekë dhe jo sa vlera reale e shitjes. Hetimi i Komisionit është kryer për të njëjtën pasuri, fakte dhe prova, për të cilën aktualisht ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë e, për pasojë, referuar legjislacionit aktual dhe praktikës së Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, subjekti i rivlerësimit ka çmuar se ndodhet në kushtet e “gjësë së gjykuar” për sa i përket deklaratimit të çmimit të shitjes së banesës në vitin 2000.

37. Në analizë të pretendimeve të sipërcituara të subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara në Komision gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

37.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për pasurinë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e apartamentit me nr. pasurie {***}, ndodhur në ZK {***}, me sip. 66,04 m², me kontratën e shitblerjes datë 17.05.2000, në vlerën 600.000 lekë, realisht shitur 4.450.000 lekë.

I njëjti burim financiar krijimi është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003.

37.2 Me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2000, z. J. Z. dhe znj. Adelina Zarka, në cilësinë e palës shitëse, i kanë shitur z. A. Z., në cilësinë e palës blerëse, pasurinë “apartament banimi me sip. 66,04 m², në Z.K. {***}, në Fier”. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, *palët shitëse i shesin palës blerëse këtë pasuri kundrejt vlerës 600.000 lekë, vlerë e cila është paguar plotësisht para redaktimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës së noterisë*. Pasuria është regjistruar po në këtë datë, në emër të blerësit, z. A. Z. Sipas të dhënave të mandatarëkëtimit nr. {***}, datë 17.05.2000, z. J. Z. ka paguar detyrimin tatimor 3.000 lekë (0,5% x 600.000 lekë) për të ardhurën e përfituar nga shitja, pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier.

37.3 Sipas të dhënave bankare të përcjella në Komision nga subjekti i rivlerësimit, në datën 17.05.2000, z. J. Z. ka kryer dy depozitime në cash në Tirana Bank, përkatësisht në shumat 3.000.000 lekë dhe 1.000.000 lekë, për çelje depozite me afat. Më pas, nga z. J. Z., në datën 20.06.2000 është tërhequr shuma 1.007.101 lekë, në datën 18.08.2000 është tërhequr shuma 2.066.353 lekë dhe në datën 25.09.2000 është tërhequr shuma 1.006.445 lekë.

37.4 Me vendimin nr. {***}, datë 02.06.2015, “Për marrjen e masës administrative për shkelje të ligjit për deklarimin e interesave privatë dhe njoftimin për marrjen e masës disiplinore institucionit epror”, ILDKPKI-ja ka disponuar se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, si dhe urdhrin nr. {***}, datë 13.03.2014, të Inspektorit të Përgjithshëm “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë”, i ndryshuar, duke vendosur masën administrative gjobë në shumën 450.000 lekë ndaj subjektit të rivlerësimit. Në këtë vendim, ndër të tjera, ILDKPKI-ja ka konstatuar mospërputhje midis deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, për vlerën e shitjes së apartamentit “apartament banimi me sip. 66,04 m², në Z.K. {***}, në Fier” në shumën 4.500.000 lekë, ndërkohë që vetë subjekti ka depozituar pranë këtij institucioni kontratën e shitblerjes së pasurisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2000, me vlerë shitjeje prej 600.000 lekësh.

37.5 Vendimi nr. {***}, datë 02.06.2015, i ILDKPKI-së është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 06.10.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë të ngritur nga paditësja Adelina Zarka. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 28.03.2018, mbi ankimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit, vendosi ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 06.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 02.06.2015, të ILDKPKI-së për sa i takon masës administrative me gjobë, duke e zbritur atë nga masa 450.000 lekë në 100.000 lekë. Gjoba e sipërcituar është paguar nga subjekti i rivlerësimit në datën 23.08.2018.

38. Në analizë të situatës faktike sa më sipër, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çmimi i shënuar në kontratën e shitblerjes së pasurisë “apartament banimi me sip. 66,04 m², në Z.K. {***}, në Fier”, në shumën 600.000 lekë është thjesht një lapsus i bërë pa asnjë qëllim, pasi çmimi

i vërtetë është ai prej 4.500.000 lekësh, trupi gjykues vlerësoi se palët pjesëmarrëse në kontratën e shitblerjes së pasurisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2000, kanë shprehur dhe realizuar vullnetin e tyre për një vlerë shitjeje të pasurisë, prej 600.000 lekësh. Për pasojë, kontrata e shitblerjes e lidhur mes tyre para noterit publik, në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil¹⁶ dhe nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile¹⁷, ka forcën e ligjit për palët dhe përbën provë të plotë të deklarimeve të tyre para noterit, për faktet që kanë ngjarë në prani të tij. Kontrata e sipërcituar e shitblerjes i ka sjellë efektet e saj që në datën e nënshkrimit, pasi më datë 17.05.2000, pasuria është regjistruar në regjistrat publikë në emër të blerësit dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar detyrimin tatimor për kalimin e së drejtës së pronësisë, për shumën e përfituar prej 600.000 lekësh, si vlerën e shitjes së pasurisë shënuar në kontratën përkatëse. Të gjitha këto fakte nuk arritën ta bindin trupin gjykues se çmimi prej 600.000 lekësh i vendosur në kontratë ka qenë thjesht një lapsus, dhe çmimi prej 4.450.000 lekësh, shumëfish më i lartë, të ketë qenë çmimi i vërtetë, përveçse ky çmim, me dijeninë e plotë të palëve nuk është bërë objekt i kontratës së shitjes, jo pa qëllim, por për të shmangur pagimin e tatimit të kalimit të pronësisë në një vlerë më të lartë, nga pala shitëse – subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj. Gjithashtu, duke pasur në konsideratë diferencën e madhe të vlerës mesatare të shitjes në tregun të lirë të banesave, e cila rezulton të jetë 2.843.022 lekë¹⁸, dhe asaj të pretenduar si çmimi real i shitjes prej 4.450.000 lekësh, e që nuk justifikohet as nga vendndodhja e banesës pranë qendrës së qytetit, nuk provohet se vlera reale e shitjes ka qenë sa vlera e pretenduar prej subjektit të rivlerësimit.

Në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se megjithëse depozitimet në *cash* të shumës totale prej 4.000.000 lekësh nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në Tirana Bank, janë kryer në të njëjtën datë me lidhjen e kontratës së shitblerjes së pasurisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2000, nuk u gjet asnjë gjurmë apo e dhënë që të provojë se këto depozitime buronin nga vlera e pretenduar si e përfituar nga shitja e apartamentit. Edhe në përshkrimin e veprimit bankar për depozitim të vlerave prej 3.000.000 lekësh dhe 1.000.000 lekësh, në datën 17.05.2000, nga z. J. Z., citohet “*depozitim cash*”, pa specifikuar burimin e shumave të depozituara.

38.1 Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se hetimi i Komisionit është kryer në kushtet e “gjësë së gjykuar”, pasi ajo është ndëshkuar një herë me gjobë nga ILDKPKI-ja dhe, në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 28.03.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka paguar gjobën e caktuar, trupi gjykues vlerësoi se kontrolli i pasurisë së subjektit të rivlerësimit

¹⁶ Neni 690 i Kodit Civil, përcakton se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkakë të parashikuara me ligj”.

¹⁷ Neni 253 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”.

¹⁸ Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 14.07.2000, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, vlera mesatare e apartamenteve tip të tregut të lirë të banesave, për vitin 2000, për qytetin e Fierit, është në vlerën 43.050 lekë/m² x 66,04 m² sipërfaqja e banesës së shitur = 2.843.022 lekë, vlera mesatare e tregut të lirë.

për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar, autorizohet nga përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ato të ligjit të posaçëm nr. 84/2016, me një metodologji dhe procedurë të posaçme, me qëllim dhe funksion të përcaktuar dhe të ndryshëm nga kontrolli periodik i zyrtarëve deklarues, referuar ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”. Rivlerësimi kalimtar, për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, aplikohet dhe kryhet vetëm një herë dhe vendimarrja u përket organeve të rivlerësimit.

Çmimi i shitjes së apartamentit me sipërfaqe 66,04 m² në Fier, është bërë objekt kontrolli nga Komisioni si pasojë e deklarimit të tij në deklaratën e rivlerësimit, si burim financiar për krijimin e pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë” dhe me qëllim reflektimin e këtij burimi në analizën financiare përkatëse. Siç rezultoi edhe nga arsyetimi i pasqyruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit, që të konsiderojë si të ardhur të ligjshme nga shitja e apartamentit vlerën prej 600.000 lekësh, aq sa është përcaktuar në kontratën e shitblerjes së pasurisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2000. Sa më sipër, si dhe në referim të parashikimeve të nenit 451/a, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile¹⁹ dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese²⁰, hetimi dhe vlerësimi i Komisionit lidhur me pasurinë “apartament me sip. 66,04 m² në Fier”, nuk gjendet në kushtet e zbatimit të parimit të “gjësë së gjykuar”. Trupi gjykues vlerësoi se Komisioni ka vepruar në përputhje të plotë me kompetencën që i ka dhënë neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe neni 4 i ligjit nr. 84/2016, për kryerjen e procesit të rivlerësimit.

39. Trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor çmimin real të shitjes së pasurisë “apartament me sip. 66,04 m² në Fier”, i pretenduar në vlerën 4.450.000 lekë dhe jo në vlerën 600.000 lekë, sa çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2000.
40. Trupi gjykues vlerësoi se edhe në versionin që kjo shumë mund të konsiderohej si çmimi real i shitjes së pasurisë, përsëri ajo nuk mund të konsiderohej si e ardhur e ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, pasi për përfitimin e kësaj shume, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk është përmbushur detyrimi ligjor për shlyerjen e detyrimit tatimor për kalimin e së drejtës së pronësisë, i përcaktuar nga dispozitat e ligjit të kohës nr. {***}, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim, pasi e gjeti të pabazuar në prova e në ligj pretendimin e subjektit të rivlerësimit se duke paguar gjobën e vendosur si masë ndëshkuese nga ILDKPKI-ja, në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 28.03.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila është më e madhe se diferenca e papaguar e detyrimit tatimor si pasojë e çmimit më të lartë të deklaruar të shitjes së apartamentit, të ardhurat e përfituara në shumën prej 4.450.000 lekësh duhet të konsiderohen të ligjshme. Në vlerësimin e trupit gjykues, gjoba e paguar

¹⁹ Neni 451/a i Kodit të Procedurës Civile përcakton: “[...] Vendimi që ka marrë formë të prerë, ka fuqi vetëm për çfarë është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe”.

²⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 24/2008.

nga subjekti i rivlerësimit si pasojë e një mase administrative për shkelje të parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, nuk mund të barazohet në asnjë element me pagesën e detyrimit tatimor për kalimin e së drejtës së pronësisë, pagesa e të cilit bëhet përmes një organi përgjegjës, mënyre përlllogaritjeje dhe procedure krejtësisht të ndryshme, të parashikuar nga legjislacioni përkatës.

41. Në përfundim, trupi gjykues e konsideroi të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e shumës prej 4.450.000 lekësh, si burim të ligjshëm financiar për investimin e kryer në ndërtimin e pjesës takuese, të pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”.
42. Në drejtim të verifikimit të mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të investuar burime të ligjshme në ndërtimin e pjesës takuese të pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, trupi gjykues mori në analizë pretendimin lidhur me huatë në shumën totale prej 2.600.000 lekësh, për të cilat, Komisioni, në vendim²¹, ka vlerësuar se ato nuk janë deklaruar as më parë dhe as në deklaratën e rivlerësimit dhe, në vijim të një praktike të konsoliduar të vendimeve të ngjashme nga Kolegji, nuk mund të konsiderohen si burime të ligjshme për të financuar ndërtimin e pjesës takuese të pasurisë objekt kontrolli.
43. Në mbështetje të pretendimit të saj, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni dhe rezultateve të hetimit administrativ, duke argumentuar se në kushtet kur huatë janë deklaruar prej personit të lidhur te një institucion shtetëror, në datën 14.03.2003, deklarim i kryer edhe në aplikimet vijuese për pajisjen me certifikatë sigurie pranë DSIK-së, e ka konsideruar të ezauruar këtë deklarim. Mosdeklarimi nga ana e saj, ka ardhur nga mungesa e përvojës dhe trajnimeve apo orientimeve në plotësimin e deklaratës së pasurisë në vitin 2003, pasi, sapo ishte miratuar ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, ekzistenca e marrëdhënieve të huasë, është provuar përmes deklaratave noteriale të lëshuara nga huadhënësit dhe të depozituara gjatë hetimit administrativ në Komision. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar mundësinë financiare të huadhënësve për dhënien e huave në shumat përkatëse.
44. Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe konfirmoi qëndrimin e Komisionit lidhur me mospërfshirjen e huave në shumën totale prej 2.600.000 lekësh, në burimet e krijimit të pasurisë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, si vijon.
Së pari: Huatë e pretenduara se janë marrë në periudhën 2000-2002, nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si një nga burimet financiare të krijimit për pasurinë objekt kontrolli. Mungesa e këtij deklarimi nuk duket të ketë ardhur si pasojë e mospasjes së përvojës në plotësimin e deklaratës së pasurisë së vitit 2003, siç pretendon subjekti, pasi edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, e plotësuar në kushtet e përgjegjësisë së posaçme që prodhonte ky deklarim, ajo nuk i ka identifikuar huatë e pretenduara, si burime financiare krijimi për pasurinë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”. Trupi gjykues e gjeti të pabazuar në prova edhe pretendimin

²¹ Paragrafi 1.26 i vendimit të Komisionit.

tjetër të subjektit të rivlerësimit, se huatë ishin deklaruar nga bashkëshorti i saj në formularin e DSIK-së për pajisjen me certifikatë sigurie. Kopja e formularit të DSIK-së, e plotësuar nga z. J. Z., paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit në Komision, nuk bindi trupin gjykues mbi autenticitetin e saj, në kushtet e një kopjeje jo të njësuar me origjinalin nga autoriteti përgjegjës, që e ka administruar atë në kohën e paraqitjes së kërkesës nga z. J. Z.

Së dyti: Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar për herë të parë huatë si burim financimi për ndërtimin e pjesës takuese të pasurisë objekt kontrolli, në përgjigjet e pyetësorit të datës 07.02.2020, të drejtuar nga Komisioni, dhe ka paraqitur, në mbështetje të këtij qëndrimi, deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2020, me deklarues J. dhe N. B., të cilët deklarojnë se i kanë dhënë vajzës së tyre, subjektit të rivlerësimit, në vitin 2000, huanë në shumën 400.000 lekë, *pa shkresë, pa interes dhe pa afat*; deklaratën noteriale me nr. {****} rep., nr. {****} kol., datë 06.02.2020, me deklarues J. P., i cili deklaron se i ka dhënë hua shokut të tij J. Z. shumën 2.000.000 lekë, në vitin 2000, *për të bërë të mundur mbarimin e shtëpisë*; deklaratë e thjeshtë nga e-mail-i personal i datës 08.05.2021, i z. Th. L., i cili deklaron se në vitin 2002, i ka dhënë hua z. J. Z., *pa shkresë, pa interes, shumën 200.000 lekë*. Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, ka ndryshuar qëndrimin e saj lidhur me burimet financiare të përdorura për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, në raport me deklaratimet e saj në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, duke u përpjekur të shtojë burimet financiare në përgjigje të nevojës për të justifikuar investimin e ndërtimit të saj me burime të ligjshme.

Në vlerësim të kësaj situatë, trupi gjykues, në mungesë të deklarimeve mbi marrëdhëniet e huasë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me udhëzimin nr. {****} prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së, dhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, si dhe as në ndonjë dokument ligjor të kohës kur këto marrëdhënie kanë lindur, risjell në vëmendje se në vijim të jurisprudencës së Kolegjit²², deklarata noteriale e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, pas rezultateve të hetimit administrativ, ka vlerë të kufizuar për sa i përket provueshmërisë së fakteve që kërkon të provojë, për sa kohë që ato nuk mbështeten nga të dhëna të tjera që rezultojnë nga dokumentacioni ligjor i krijuar jashtë ndikimit të procesit të rivlerësimit. Dokumentacioni i sipërcituar, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, nuk u konsiderua i mjaftueshëm nga trupi gjykues për të arritur në konkluzionin se marrëdhëniet e huasë kanë ekzistuar, për arsye që u përmendën më lart.

45. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se marrëdhëniet e huasë me z. J. dhe znj. N. B., me z. J. P. dhe z. Th. L., kanë mbetur të paprovuara prej subjektit të rivlerësimit dhe në nivel deklarativ, për pasojë shuma totale prej 2.600.000 lekësh, e pretenduar si hua e marrë prej tyre, nuk mund të konsiderohet si një burim i ligjshëm që ka shërbyer për financimin e ndërtimit të pjesës takuese në pasurinë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”.
46. Duke reflektuar konkluzionet e mësipërme në kontrollin e analizës financiare të kryer nga Komisioni për burimet e financimit të ndërtimit të pjesës takuese të pasurisë “apartament me dy

²² Vendimi i Kolegjit nr. 6/2018 (JR); nr. 11/2018 (JR); nr. 34/2019 (JR); nr. 2/2020 (JR); nr. 5/2020 (JR); nr. 23/2020 (JR); nr. 36/2020 (JR) etj.

kate banimi dhe një kat magazinë” në vlerën e përlllogaritur prej 8.563.590 lekësh, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar shpenzimet e kryera për ndërtimin e kësaj pasurie, në shumën prej (-) 5.527.965 lekësh.

Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

47. Trupi gjykues shqyrtoi dhe shkaqet e ankimit referuar vendimmarrjes së Komisionit, i cili, pasi ka kryer vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka konkluduar, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, gjendet në situatën e konfliktit të interesit, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, që ka shërbyer si një nga shkaqet për shkarkimin e saj nga detyra.
48. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, është njohur me vendimin nr. {***}, datë 21.02.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me të cilin ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit L. Z., vjehrrit të saj, për regjistrimin si “person fizik” dhe lejimin e ushtrimit të aktivitetit “Bufe-bilardo”. Komisioni, pasi ka konstatuar se në periudhën kohore kur është shqyrtuar kjo çështje, subjekti i rivlerësimit ka qenë e martuar me z. J. Z. dhe figuron në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit e bashkëshortit, ka vlerësuar se ajo nuk duhet ta kishte trajtuar kërkesën e sipërcituar të vjehrrit të saj, me cilësinë e gjyqtares, dhe se ky veprim e vendos në kushtet e shkronjës “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

48.1 Komisioni ka konstatuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen nr. {***}, për të cilën ka marrë vendimin nr. {***}, datë 24.07.2018, me palë kërkuuese Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe palë kallëzuese shoqërinë tregtare “{***}” LTD, duke vendosur pushimin e çështjes për procedimin penal nr. {***}, datë 26.07.2012. Komisioni ka arritur në konkluzionin se në periudhën kohore kur është shqyrtuar kjo çështje, shoqëria “{***}” LTD vijonte marrëdhëniet kontraktuale të qirasë me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, z. J. Z, për pasurinë “apartament me dy kate banimi dhe një kat magazinë”, me pagesë 3.200 euro në muaj, dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për këtë kontratë, të cilën e ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratimet periodike vjetore, për pasojë subjekti i rivlerësimit e ka gjykuar çështjen duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit sipas shkronjës “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

49. Subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, në ankim, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në deklaratimet e saj gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar se Komisioni, duke vlerësuar vetëm kriterin e pasurisë, e ka vendosur në kushtet e konfliktit të interesit lidhur me çështje të shkëputura, të cilat janë minimale në raport me ngarkesën, problemet dhe presionet që i është dashur të përballojë gjatë gjithë punës së saj. Subjekti i rivlerësimit saktëson se marrëdhëniet kontraktuale e qirasë me shoqërinë “{***}” LTD nuk ka ndikuar në punën e saj, për më tepër në gjykimin e një çështjeje penale të veçantë, me objekt pushimin e çështjes për efekt të plotësimit të afateve të parashkrimit dhe po ashtu, marrja e një vendimi për regjistrimin e vjehrrit të saj si person fizik, në kushtet e një

ngarkese optimale pune, nuk mund të përbëjnë në vetvete cenim të figurës së magistratit apo cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

50. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në funksion të konkluzioneve të arritura nga Komisioni, trupi gjykues vëren se konflikti i interesit, sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Si interesa privatë të zyrtarit, që mund të dëshmojnë konfliktin e mundshëm të interesit, ligji i sipërcituar ka renditur edhe interesat që burojnë nga *angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi*, si dhe *interesat që burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës*²³.
51. Në analizë të fakteve të konstatuara drejt nga Komisioni, në raport me legjislacionin e zbatueshëm të cituar më sipër, trupi gjykues analizoi si më poshtë.

51.1 Kontrata e qirasë nr. {***}, e lidhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “{***}” LTD si palë qiramarrëse, ka filluar të zbatohet në datën 01.11.2006 dhe është shtyrë me marrëveshje të palëve ndër vite deri në datën 30.09.2020. Kjo situatë e vendoste subjektin e rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit për të shqyrtuar çështjen penale nr. {***}. Subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar këtë çështje, për të cilën ka dhënë edhe vendimin nr. {***}, datë 24.07.2018, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 17, pika 1, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Penale²⁴. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit nuk duket të ketë krijuar, në momentin e gjykimit të çështjes penale të sipërtrajtuar, një interes të ri pasuror me shoqërinë “{***}” LTD dhe as të ketë dhënë një vendim në favor të interesave të kësaj shoqërie, konkludoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit nuk mund të kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016. Kjo sjellje nuk mund të kualifikohet as sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, pasi procesi i rivlerësimit për subjektin është kryer vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

51.2 Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu se edhe shqyrtimi i kërkesës dhe marrja nga subjekti i rivlerësimit i vendimit nr. {***}, datë 21.03.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për

²³ Neni 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, shkronjat “d” dhe “dh”, nënpika “i”.

²⁴ Neni 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, sipas formulimit në fuqi në vitin 2018, parashikonte që: “1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij; b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërit prej palëve private; d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. 2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse”.

regjistrimin e z. L. Z. si person fizik dhe lejin e ushtrimit të aktivitetit “Bufe-bilardo”, është bërë në kushtet e papajtueshmërisë, situatë e cila bënte të detyrueshme paraqitjen e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit nuk mund të kualifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, por ajo mund të vlerësohet brenda kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, nëse procesi i rivlerësimit të saj në Komision, do të kishte përfshirë edhe këtë kriter.

52. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Adelina Zarka, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e po këtij ligji, për pasojë vendimi nr. 446, datë 16.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e saj nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 446, datë 16.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Adelina Zarka
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 18.03.2024.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi